



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY
Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0647

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105,106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP), në përbërje nga Isa Hasani-Kryetarë, Vedat Poterqoi-Anëtar dhe Vjosa Gradinaj-Mexhuani-Anëtare, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) “BE NEW ” L.L.C.”- Prishtinë, kundër Vendimin për dhënie të kontratës, Ministria e Infrastrukturës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit “Qendra mobile për kontrollim teknik te automejteve ne rruge” me nr. të prokurimit: "205-23- 6058-1-1-1", me datën 12.12.2023, mori këtë:

Vendim

1. Miratohet si e bazuar ankesa e Operatorit Ekonomik, "" BE NEW " L.L.C.”-, me numër; 2023/0647, kundër "Njoftim Mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues", Ministria Infrastrukturës, për dhënie të kontratës për aktivitetin e prokurimit ""Qendra Mobile për Kontrollim Teknik të Automjeteve në Rruge" nr. të prokurimit: "205-23- 6058-1-1-1", dhe lënda kthehet në Rivlërsim.
2. Anullohet, "Njoftimi Mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues", Ministria Infrastrukturës, i datës, 21.10.2023, për dhënie të kontratës për aktivitetin e prokurimit ""Qendra Mobile për Kontrollim Teknik të Automjeteve në Rruge" nr. të prokurimit: "205-23- 6058-1-1-1".
3. Lejohet kthimi i mjeteve të depozituara në emër të tarifës ankimore OE ""BE NEW " L.L.C.”- Prishtinë, sipas paragrafi 4, 5 të nenit 31 të Rregullores së Punës së OSHP, kurse ankuesi ka të drejtë që sipas paragrafi 6, të dispozitës së cituar, të kërkojë kthimin e mjeteve në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi, në të kundërtën mjetet konfiskohen dhe kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

-Faktet dhe rrethanat procedurale -

Ministria e Infrastrukturës, në cilësinë e autoritetit kontraktues më datën 13.06.2023, ka publikuar Njoftimin për Kontratë, afati i fundit për dorëzimin e tenderëve ishte me datë: 28.07.2023. Me datë 21.10.2023, ka publikuar B58 Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, për dhënie të kontratës për aktivitetin e prokurimit me titull: “Qendra mobile për Kontrollim Teknik te Automjeteve në Rruge” me nr. të prokurimit: "205-23- 6058-1-1-1, ku është rekomanduar për kontratë, Grupi i operatoreve

ekonomik "Traffiks VA SH.P.K; Autoinstrument dooel Skopje".

Me datë 22.08.2023, OE ankues ka bërë Kërkesë për rishqyrtim, ndërsa me datë 29.08.2023, AK Ministria e Infrastrukturës, refuzon si të pa pabazuar Kërkesën për rishqyrtim të OE "BE NEW " L.L.C."-Prishtinë", për aktivitetin e prokurimit lart shënuar.

Ankuesi i pakënaqur me vendimin e AK-se, lidhur me Kërkesën për rishqyrtim, OE"BE NEW " L.L.C." me seli ne Prishtine, konform nenit 108/A ka parashtruar ankese ne OSHP me numër të protokollit 0647/2023,

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedure te hapur, lloji i kontratës: punë, vlera e parashikuar e kontratës: 500,000.00 €.

Organi Shqyrtues i Prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 25.09.2023 me raportin e ekspertizës. Me datë 29.09.2023, AK Ministria e Infrastrukturës, ka deklaruar se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues, ndërkaq, OE"BE NEW " L.L.C." me datën 01.10 .2023, ka deklaruar se pajtohet me mendimin e Ekspertit shqyrtues.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues konstatoi se ankesa në rastin konkret, është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP-së, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK, çdo palë e interesuar mund të parashtrojë ankese në OSHP, pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji. Meqë parashtruesit e ka statusin e palës së interesuar në kuptim të nenit 4, paragrafi 1.26, kurse ankesa përmban elementet qenësore të parapara me nenin 111, të Ligjit të cituar do të thotë se e njëjta i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave të cituara dhe bien nën kompetencat e këtij Organi, në kuptim të nenit 105, të LPP.

Paneli Shqyrtues ka konstatuar po ashtu se nuk ekzistojnë rrethana të konfliktit të interesit në kuptim të nenit 11 të Rregullores nr. 01/2020 të Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit lidhur me nenin 4 paragrafin 1 nën paragrafin 75 të LPP.

Pretendimet ankimore të operatorit ekonomik "BE NEW L.L.C." .

1.OE ankues ka parashtruar ankese kundër vendimit për dhënie të kontratës, me pretendimin se AK-ja, nuk ka respektuar procedurat e vlerësimit te ofertave. Autoriteti kontraktues, pas përfundimit të vlerësimit te ofertave e ka njoftuar OE ankues me rezultatin e vlerësimit të cilin e eliminon me arsyetimin se "CV-ja e menaxherit të projektit nuk është e nënshkruar nga inxhinieri, e cila ka qene kërkesë e dosjes se tenderit dhe arsyeja tjetër e eliminimit te OE ankues është i njëjti sipas AK-se se ka ndërhyrë ne formularët standarde të aprovuar nga KRPP-ja, ku OE ankues Deklaratën e themelimit të grupit te cilën e ka dorëzuar e ka emëruar si anexi 6 e qe sipas AK-se është pjesa e kriterëve për dhënie te kontratës".2.OE ankues pretendon se u eliminuar për atë arsye sepse vetëm e ka emëruar dokumentin si ANEXI 6 – Deklarate e themelimit te grupit dhe nuk mund te konsiderohet ndërhyrje ne formularin e KRPP-se.3.OE ankues pretendimin AK-ja, ka rekomanduar për kontrate një OE të papërgjegjshëm, se anëtari konzorciumit, i ka dorëzuar disa dëshmi te cilat janë ne kundërshtim me nenin 13 te LPP-se, sepse i ka dorëzuar te përkthyer por qe nuk kanë vule te përkthyesit zyrtar,4.OE ankues pretendon se OE i rekomanduar nuk i ka dorëzuar kontratat dhe referencat sipas kërkesës se dosjes se tenderit, me arsyetimin se anëtari konzorciumit ka dorëzuar nuk ka dorëzuar fare referencia. 5.OE ankues pretendon se OE i rekomanduar për kontrate, ka borgje ne ATK. 6.E pretendon se OE fitues nuk ka paraqitur projektin e detajuar i cili i përmban te gjitha pajisjet, se si duket një qendër mobile dhe si do te funksionoj por ka paraqitur vetëm dimensionet e kontrollës mobile dhe disa fotografi te kontrollues dhe ky dokument nuk ka te bëjë fare me projektin e detajuar ,pasi që në këtë dokument nuk është paraqitur asnjë detaj i vetëm pajisjeve te instaluara dhe funksionimi i pajisjes.7.OE pretendon se OE fitues nuk ka dëshmuar asnjë dokument apo deklarate te konfirmimitit (CE) për pajisjet qe ka ofertuar d.m.th. nuk ka prezantuar asnjë

dokument që konfirmon se pajisjet e ofertuar janë në përputhje me rregullat e BE-se ashtu siç është kërkuar nga AK në sqarimin e fundit. 8. OE pretendon se OE fitues i mungon prezantimi i Certifikatës pa deklaratë mbështetëse që konfirmon se pajisjet e ofertuar do të kalibrohen nga një laborator i akredituar, nuk është e mjaftueshme dhe bindëse për AK se pajisjet e ofertuar do të jenë të kalibruara vetëm përmes prezantimit të certifikatës së akreditimit për kalibrim të pajisjeve. 9. OE pretendon se, OE fitues ka prezantuar Certifikatën e kalibrimit për kompaninë e vet si trup certifikues e cila është në kundërshtim me standardet ndërkombëtare dhe është konflikt interesi pas që nuk mund të jesh furnizues edhe njëkohësisht trupe të akredituar për kalibrim për pajisjet që i oferton.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave -

Duke u mbështetur në neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues ka autorizuar ekspertin për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 647/23, ndërsa me datë 25.09.2023 është dorëzuar raporti i ekspertit me nr. 2023/0647.

Eksperti shqyrtues, për piken 1 ankese, sqaron se OE ankues në ofertën e tij e ka dorëzuar CV-in e Menaxherit të panënshkruar dhe për të njëjtën dëshmi AK-ja ka kërkuar në Dosje të Tenderit, që ajo të jetë e nënshkruar. Eksperti shqyrtues vlerëson se AK-ja ka mundur të sqarohet në bazë të nenit 72 të LPP-se, për faktin se nënshkrimi vërteton vetëm vërtetësinë e atij dokumenti, ndërsa dëshmitë tjera të prezantuara në CV e plotësojnë kërkesën e AK-se.

Eksperti shqyrtues, për piken 2 ankese, sqaron se pasi ka analizuar dëshmitë e dorëzuara nga OE ankues, vlerëson se nuk mund të eliminohet për atë arsye sepse vetëm e ka emëruar dokumentin si ANEXI 6 – Deklaratë e themelimit të grupit dhe nuk mund të konsiderohet ndërhyrje në formularin e KRPP-se.

Eksperti shqyrtues, për piken 3, ankese sqaron se dëshmitë e dorëzuara janë të përkthyer në gjuhën angleze, pra sipas nenit 13 të LPP-se, ndërsa lidhur me mungesën e vulës së përkthyesit zyrtar, eksperti shqyrtues vlerëson se nuk mund të eliminohet sepse nuk ka qenë kërkesë e dosjes së tenderit, prandaj, ky pretendim është i pabazuar.

Eksperti shqyrtues, për piken 4 ankese sqaron se, pas analizimit të shkresave të lëndës ka vërejtur se vetëm lideri i konzorciumit i ka dorëzuar kontratat dhe referencat në vlerë mbi 700,000.00 euro, ku kërkesë e dosjes së tenderit ka qenë: Lista e kontratave të realizuara dhe përfunduara për periudhën e shkruar tri vjeçare 2020, 2021 dhe 2023, jo më pak se 700,000.00 euro, prandaj, prandaj, ky pretendim është i pabazuar.

Eksperti shqyrtues, për piken 5 ankese, sqaron se i rekomanduari për kontratë ka marrëveshje me ATK, për shlyerjen e borxheve, andaj dhe mbi bazën e praktikave të deritashme të OSHP, nuk mund të eliminohet një OE i cili ka marrëveshje për shlyerjen e borxheve, ky pretendim është i pabazuar.

Eksperti teknik, për piken 6 ankese, sqaron se pretendimi ankimore është i bazuar sepse OE fitues nuk ka ofruar Projektin e detajuar sipas kërkesës së dosjes së tenderit " 4. Dëshmia 4.- OE duhet të prezantojë një projekt detaj se si do të funksionojë kjo qendër mobile për realizimin e qëllimit të këtij projekti."

Eksperti teknik, për piken 7 ankese, sqaron bazuar lidhur me Deklaratën e konformitetit të kërkuar nga AK në dokumente. Sqarimet në pyetjet e parashtruara nga OE, jepet AK se "Për neve është e mjaftueshme deklarata e konformitetit me të cilën sigurohet cilësia e kërkuar. Sipas Ligjit nr. 05/L/132 Për automjete certifikata e konformitetit duhet të jetë sipas kërkesave të Bashkimit Europian. Pra, produkti i cili posedon certifikatë të konformitetit (produkte të dedikuara për vendet anëtare të BE – së) i plotëson kushtet e kërkuara sipas këtij tenderi.

Eksperti teknik, për piken 8 ankese vlerëson se ankimor është i pabazuar sepse nuk është kërkuar dokument mbështetës për verifikim të kalibrimit pajisjeve në kërkesat e specifikacionit teknik.

Eksperti teknik, për piken 9, vlerëson ky pretendim ankimore është i pabazuar, sepse OE i rekomanduar për kontratë është në konzercium në këtë aktivitet të prokurimit me Laboratorin AUTOINSTRUMENT DOOEL i cili është i akredituar MKS EN ISO/IEC 17025 : 2018 nga Instituti për Akreditim në Republikën e Maqedonisë Veriore.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. OE “pajtohem me rekomandimin e ekspertit që lënda të kthehet në rivlerësim, por në disa pika kundërshtojmë arsyetimin e ekspertit në lidhje me pretendimet tona ankimore pasi që konsiderojmë se nuk janë kuptuar sakte? Për kundërshtimet e këtyre pikave kërkojmë nga Paneli i OSHP-se, të lejoje pjesëmarrjen në seance, në mënyrë të sqarojmë në detaje arsyet e kundërshtimit apo me sakte pretendimet ankimore që kemi dhënë në ankese”. AK “Nuk pajtohem me rekomandimin e raportit të ekspertit shqyrtues”.

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues-

Paneli konstaton se nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, lidhur me paragrafin 1.75, të nenit 4 të LPP dhe njëherësh analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, përderisa parashtruesat e palëve dhe veprimet e tyre, përbejnë bazë të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritues sikurse parashihet me paragrafin 1, të nenit 24 të Rregullores së Punës së OSHP, dhe se nuk ka nevojë të kërkohen nga autoriteti kontraktues dhe/ose parashtruesi i ankesës që të sigurojë informata dhe/ose shpjegime shtesë, në kuptim të paragrafit 3, të nenit 116 të LPP.

Paneli shqyrtues konstaton se vlerësimet e raportit të ekspertit mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit dhe dokumenteve me të cilat ka ofertuar ankuesi, andaj i falë besimin e plotë raportit të ekspertizës, me gjetjet se, Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore të LPP, lidhur me publikimin “Njoftimi Mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues”, Ministria Infrastrukturës, i datës, 21.10.2023, për dhënie të kontratës për aktivitetin e prokurimit “Qendra Mobile për Kontrollim Teknik të Automjeteve në Rruge” nr. të prokurimit: “205-23- 6058-1-1-1”.

Paneli shqyrtues lidhur me pretendimin si të bazuar nga eksperti shqyrtues për CV e nënshkruar nga eksperti shqyrtues ka vlerësuar se AK-ja ka mundur të sqarohet në bazë të nenit 72 të LPP-se”, Paneli konstaton se dëshmia e kërkuar dokumentare, Dëshmia 1 - CV e nënshkruar nga inxhinieri, nuk ka qene në sipas kërkesës dosjes tenderit, por që ankuesi në dosjen e tenderit ka pasur kontratë pune të cilat janë të nënshkruar, andaj konsiderohet si një devijim i vogël që ka mundur të tejkalohet ashtu që autoriteti kontraktues ka mundur të kërkojnë nga operatorët ekonomikë që të dorëzojnë, plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnë informacionin apo dokumentacionin e duhur brenda, me kusht që kërkesat e tilla bëhen në përputhje të plotë me parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës, andaj dhe Paneli shqyrtues konstaton se pretendimi ankimor është i bazuar.

Paneli shqyrtues lidhur me pretendimin si të bazuar nga eksperti shqyrtues si arsye të eliminimit, të OE ankues, eksperti shqyrtues nga analiza e dëshmive të dorëzuara nga OE ankues, vlerëson se nuk mund të eliminohet për atë arsye sepse vetëm e ka emëruar dokumentin si ANEXI 6 – deklaratë e themelimit të grupit dhe nuk mund të konsiderohet ndërhyrje në formularin e KRPP-se, andaj dhe Paneli shqyrtues konstaton si pretendim ankimor i bazuar.

Paneli shqyrtues lidhur me vlerësimin e Eksperti teknik, për pretendimin ankimor pika 6 “pretendimi ankimore është i bazuar sepse OE fitues nuk ka ofruar Projektin e detajuar sipas kërkesës së dosjes së tenderit 4. Dëshmia 4.- OE duhet të prezantojë një projekt detaj se si do të funksionojë kjo qendër mobile

për realizimin e qëllimit të këtij projekti". Paneli konstaton se eksperti teknik vlerëson se OE fitues në projektin e prezantuar vetëm ka bërë përshkrimin e funksionimit dhe ka dhënë dimensionet e qendrës mobile për kontrollim teknik të automjeteve në rrugë, por nuk ka bërë përshkrimin në detaj të pajisjeve të cilat janë të vendosura brenda qendrës mobile siç është kërkuar në DT, andaj dhe Paneli konstaton si pretendim ankimor i bazuar.

Paneli shqyrtues konstaton se Operatori Ekonomik ankues në këtë rast ka ofruar argumente që do të ndryshonin Vendimin e AK, e po ashtu rekomandimi i ekspertëve shqyrtues, andaj duke u bazuar nga të gjitha si që u thanë si më sipër është vendosur që ankesa e OE ankues të miratohet si bazuar, ndërsa anulohet vendimi i AK, "Njoftim Mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues", Ministria Infrastrukturës, për dhënie të kontratës për aktivitetin e prokurimit "Qendra Mobile për Kontrollim Teknik të Automjeteve në Rrugë" nr. të prokurimit: "205-23- 6058-1-1-1" dhe lënda kthehet në Rivlersim.

Paneli shqyrtues duke i vlerësuar tiparet kryesore të LPP-së, që janë ekonomociteti, efikasiteti dhe kursimi i buxhetit të shtetit duke u bazuar nga të gjitha faktet, arsyet dhe gjendjen faktike që u përshkrua si më sipër, të dokumenteve të DT dhe dokumenteve të Autoritetit kontraktues, vëren se OE i rekomanduar është me çmim të ofertës me të lartë prej 29.900 euro, se sa OE ankues. Andaj, PSH kërkon që bazuar në gjetjet e mësipërme, AK pas rivlerësimit të tyre, sipas diskrecionit ligjor të tij të merr vendim konform dispozitave ligjore të LPP.

Prandaj duke vepruar mbi bazën e parimeve themelore të procedurave për shqyrtimin e prokurimit, të cilat mes tjerash, janë sanksionuar në mënyrë të veçantë me dispozitën e nenit 104, të LPP dhe njëherësh duke i analizuar shkresat e kësaj lënde në relacion me faktet dhe rrethanat e përshkruara si më sipër, e posaçërisht duke i kushtuar kujdesin e duhur po ashtu dhe natyrës dhe qëllimit të pretendimeve ankimore, Paneli Shqyrtues mori në konsideratë të gjitha pohimet e ankuesit, aktet dhe veprimet e ndërmarra nga AK, raportin e ekspertit shqyrtues dhe i analizoi me kujdes të gjitha shkresat e kësaj lënde dhe konsideron se pohimet ankimore të OE ankues janë të paqëndrueshme ashtu siç janë dhënë në konstatimin e panelit.

Andaj, duke vepruar në pajtim me kompetencat e cituara si më sipër dhe nenin 104 paragrafi 1 dhe 4 të LPP-së, sipas të cilit procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e ligjshme dhe efektive të lëndës, si dhe duke ju referuar nenit 117 të LPP-së, dhe në provat e prezantuara si më lartë Paneli Shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Lidhur me tarifën ankimore, Paneli Shqyrtues vendosi konform nenit 31 pika 5, të Rregullores së Punës së OSHP, lidhur me nenin 118 të LPP.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Isa Hasani

Hasani

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - MINISTRIA E INFRASTRUKTURES, MINISTRIA E INFRASTRUKTURES**
- **OE - " BE NEW " L.L.C., " Profitech " SH.P.K.**
- **Arkivës së OSHP-së:**